

Komuna e Prishtinës: Problemet kryesore dhe trendet buxhetore

Hyrje

1. Komuna e Prishtinës që nga zgjedhjet e para lokale në vitin 2000 udhëhiqet nga Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK). Kryetari aktual i saj është Isa Mustafa.
2. Kryetari Mustafa, përveç ushtrimit të funksionit të kryetarit të komunës, mban pozitën e të parit në partinë më të madhe opozitare në vend, LDK-së.
3. Në mandatin e parë të kryetarit të tanishëm, 2007-2009, Prishtina është bashkë-qeverisur mes LDK-së dhe PDK-së. Kjo e fundit ka udhëhequr me tri Drejtori në Komunën e Prishtinës (Urbanizmin, Financat dhe Shëndetësinë). Në mandatin e dytë, Mustafa e ka konsoliduar i vetëm ekzekutivin pa pasur nevojë të hyjë në ndonjë koalicion pas zgjedhor.
4. Sipas regjistrimit të fundit i popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave, Prishtina ka 198.897 banorë.¹ Këto të dhëna nuk janë pranuar asnjëherë nga Komuna e Prishtinës duke pretenduar se në Prishtinë jetojnë shumë më shumë banorë.
5. Në bazë të hulumtimit të opinionit të qytetarëve nëpër komunat e vendit i realizuar nga USAID/DEMI, kënaqshmëria e qytetarëve të Prishtinës me kryetarin e komunës ka ardhur duke rënë. Kësisoj, në bazë të këtij hulumtimi gjatë vitit 2011, 68% janë deklaruar të kënaqur me punën e Kryetarit të Komunës, përderisa kjo përqindje ka rënë në 65% në 2012. E ulët mbetet edhe përqindja e prishtinasve të kënaqur me punën e administratës komunale. Kësisoj, 58% janë deklaruar të kënaqur, përderisa në komunat e tjera kjo kënaqshmëri shkon në mesatare mbi 70%.²

¹ Agjencia e Statistikave të Kosovës. Rezultatet përfundimtare për Regjistrimin e Popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave - 2011. Burimi: http://esk.rks.gov.net/rekos2011/repository/docs/Te%20dhenat%20kryesore_ALB.pdf

² Programi i Shteteve të Bashkuara të Amerikës për Zhvillim (USAID). Raporti i anketimit mbi kënaqshme rinë e qytetarëve me shërbimet komunale. Fq 12. Burimi: http://www.demi-ks.org/repository/docs/Citizen_Satisfaction_Report-Shqip.pdf

6. Ndërsa hulumtimi i UNDP-së, Mozaiku i Kosovës 2012 tregon se 69% e prishtinasve konsiderojnë se problemet në lagjet e tyre mund t'i zgjidh komuna, përderisa 24% e prishtinasve, në krahasim me mesataren e Kosovës 15%, vlerësojnë se problemet në zonat e tyre mund t'i zgjidh vetëm Qeveria.³
7. Në hulumtimin e bërë në terren në vitin 2009 nga Instituti GAP, Prishtina në atë kohë ka pasur këto probleme: komunikacion të dendur, mungesë të parkingjeve, mungesë të ujit të pijes, mos mirëmbajtje të ndërtesave kolektive, mungesë të hapësirave të gjelbëruara si dhe pamje të shëmtuar të qytetit.⁴

Problemet aktuale të Komunës së Prishtinës

- 1. Problemet me regjistrimin (përkthimin) e pronave private.** Pjesa më e madhe e pronave, shtëpive dhe banesave në Prishtinë nuk janë të regjistruara në emër të personave të ligjshëm. Mos përkthimi dhe regjistrimi i këtyre pronave, sipas qytetarëve, vjen nga mungesa e vullnetit institucional që do të inkurajonte dhe lehtësonte nisjen e një procesi të gjerë të regjistrimeve. Përveç kësaj, shumëllojshmëria e dokumentacionit që kërkohet dhe kostoja e lartë e përkthimit të pronave kanë qenë faktorë shtesë që u kanë pamundësuar qytetarëve përkthimin e pronave.
- 2. Problemet në transportin urban.** Komuna e Prishtinës menaxhon me ndërmarrjen “Trafiku Urban”. Kjo kompani në vazhdimësi ka operuar me humbje, pa pasur mundësi t'i paguajë rregullisht punëtorët dhe pa mundësi financiare për të planifikuar investime kapitale (blerje të autobusëve).⁵ Nga 18 autobusë sa llogaritet t'i ketë kjo ndërmarrje, vetëm shtatë prej tyre janë në gjendje të rregullt, pjesa tjetër janë jo funksional.⁶ Me këtë gjendje dhe numër të autobusëve, “Trafiku Urban” mbulon vetëm dy linja të udhëtarëve, linjën 4 dhe linjën 3A. Linjat tjera mbulohen nga operatorë privat. Shumica e autobusëve nuk plotësojnë kushtet e kërkuara

³ Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim –UNDP. “Mozaiku i Kosovës”. 2012. Fq 126.

Burimi: http://www.undp.org/content/dam/kosovo/docs/Mozaik/Kosovo_Mosaic_2012_Alb_216825.pdf

⁴ Instituti GAP. Raporti Komunal. Komuna e Prishtinës. Nëntor 2009. Fq 9.

⁵ Gazeta “Zëri”. Autor, Lendita Canolli. 29.03.2013. Letra që flet për parregullsitë në “Trafikun Urban”. Burimi: <http://www.zeri.info/artikulli/2807/letra-anonime-flet-per-parregullsite-ne-trafikun-urban>

⁶ Portali informativ “Indeksonline”. 18 dhjetor 2012. Autobusët Jashtë Përdorimit qarkullojnë nëpër Kryeqytet. Burimi:

<http://www.indeksonline.net/?FaqeID=2&LajmID=40819>

teknike për bartjen e udhëtarëve. Nuk kanë qenë të pakta aksidentet që kanë shkaktuar këta autobusë gjatë lëvizjes nëpër qytet, duke rrezikuar edhe udhëtarët.⁷ Përveç kësaj, shpenzimet për derivate dhe mirëmbajtje teknike të këtyre autobusëve vlerësohen të jenë të larta. Orari i qarkullimit të autobusëve nuk respektohet as nga “Trafiku Urban”, por as nga operatorët privat. Periferia e qytetit është e mbuluar me autobus vetëm deri në ora 21:00. Nga ora 18:00 deri në orën 21:00 në relacionet për në periferi të qytetit qarkullojnë autobusët vetëm një herë në ore. Në dy linjat e qarkullimit të cilat mbulohen nga “Trafiku Urban” operojnë dhjetëra vetura dhe minibusë ilegale të cilët bartin udhëtarë. Kjo vlerësohet të ketë ardhur kryesisht nga pamundësia e trafikut urban për të ofruar shërbime të shpejta dhe tërheqëse. Mundësia e operimeve ilegale shkakton humbje për “Trafikun Urban” dhe njëherazi nuk ofron siguri fizike për udhëtarët.⁸

- 3. Mungesa e ujit të pijes.** Gjendja aktuale e furnizimit të qytetarëve me ujë të pijes në kryeqytet është e ngjashme me gjendjen e cila ka mbizotëruar para fushatës zgjedhore 2009. Zonat e kryeqytetit “Dardania,” “Qendra,” “Ulpiana,” “Bregu i Diellit,” “Sofalia,” dhe “Arbëria” ballafaqohen me reduktime të ujit të pijes, ndërsa kapaciteti i ujit përgjithësisht është i dobët. Planifikimet e udhëheqësve të kompanisë së ujësjetës “Prishtina” dhe Komunës së Prishtinës për të ndërtuar fabrikën e ujit në fashitin Shkabaj, kanë ngecur me vite. Fillimisht ishte proklamuar viti 2010 si vit i nisjes së kësaj fabrike, pastaj viti 2012, dhe as tani kur është gjysma e dytë e vitit 2013 nuk i gjen punët e nisura në ndërtimin e kësaj fabrike. Nga planifikimet e para besohet se do të duhet më së paku dy vite deri në ndërtimin e saj dhe deri në një vit në funksionalizimin e plotë të saj. Kësisoj, nëse ndërtimi i kësaj fabrike nis në fillim të 2014, atëherë deri në 2017 nuk mund të pritët normalizimi i gjendjes me furnizim me ujë të pijes në kryeqytet. Në bazë të hulumtimit të opinionit të qytetarëve nëpër komuna i realizuar nga UNDP, vetëm 24% e prishtinasve (në krahasim me mesataren e Kosovës prej 42%), kanë furnizim të pakufizuar me ujë. Gjashtëmbëdhjetë për qind kanë ndërprerje të furnizimit me ujë prej 1 deri në 4 orë në ditë, 38% kanë ndërprerje të ujit për 5 deri në 10 orë në ditë, kurse për 20% të tyre,

⁷ Një rast i tillë ka ndodhur në nëntor të vitit 2011 kur autobusi i linjës 4 ka dal nga rruga në afërsi të xhamisë së gurit (kryqëzimi i rrugës “Agim Ramadani” dhe “Ilir Konushevi”) ku për pasojë dy qytetarë janë lënduar, njëri nga ta udhëtar në autobus.

⁸ Gazeta “Zeri”. 04.06.2013. Lendita Canolli. Operatorët ilegal nuk ka kush i ndal.

Burimi: <http://www.zeri.info/artikulli/7084/operatoret-ilegale-nuk-ka-kush-ti-ndale>

ndërprerjet e furnizimit me ujë zgjasin më shumë se 11 orë në ditë. Përqindje e madhe e familjeve të lidhura me ujësjellësin publik në Prishtinë kanë raportuar se cilësia e ujit të pijshëm është e dobët. Njëzet e tre për qind e tyre kanë deklaruar se uji i çezmës është i turbullt nga papastërtia, 27% se shtypja e ujit është shumë e vogël për shfrytëzim shtëpiak, dhe nga 18% kanë thënë se ka shije dhe erë të keqe.⁹

4. Ndërtimet pa leje dhe uzurpimi i hapësirave publike.

Ndërtimet pa leje si dhe uzurpimi i pronës publike dhe hapësirave publike kanë prekur të gjitha zonat e Prishtinës. Nuk ekzistojnë shifra zyrtare se sa ndërtime pa leje janë në Prishtinë. Komuna ka nisur procesin e legalizimit të ndërtimeve pa leje në korrik të vitit 2010, ku edhe aplikuan 6.158 persona për t'i legalizuar ndërtimet e tyre, por kjo shifër besohet të jetë tejet e vogël në krahasim me numrin real të ndërtimeve pa leje në kryeqytet.¹⁰ Pjesa dërmuese e atyre që kanë aplikuar në procesin e legalizimeve kanë qenë pronat që kanë kryer mbindërtime në kryeqytet si dhe një numër sosh kanë synuar t'i legalizojnë objektet e ndërtuara në prona të kontestueshme. Procesi i legalizimeve nuk është përcjell me ndonjë detyrim për pronat që të aplikojnë në këtë proces, përveç inkurajimit të tyre për t'u bërë pronarë të ligjshëm të objekteve të caktuara. Deri në muajin qershor të këtij viti janë legalizuar 131 objekte. Një pjesë e madhe e atyre që kanë aplikuar për legalizim janë tërhequr nga ky proces, shkaku i kostos së madhe për të paguar dhe shkaku që nuk ekziston ndonjë sanksion ndaj atyre që nuk kanë aplikuar në këtë proces.¹¹ Nisja e procesit të legalizimeve në kryeqytet ka pasur edhe qëllimin e ndaljes së ndërtimeve pa leje, e njohur si "Dita Zero", e nisur me 15 gusht të vitit 2011. Që nga ajo kohë e deri në qershor të vitit 2013 nga të dhënat zyrtare në Komunë të Prishtinës rezulton se janë ndërtuar afro 800 objekte të ndryshme pa leje ndërtimi.¹² Krahas problemeve që ekzistojnë në kryeqytet me ndërtimet pa leje, problem i madh paraqet keqpërdorimi dhe tjetërsimi i hapësirave dhe pronave publike. Komuna nuk ka një evidencë e cila do të tregonte në mënyrë të detajuar se cilat prona publike janë uzurpuar. Drejtorja e Inspektionit në

⁹ Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim –UNDP. "Mozaiku i Kosovës". 2012. Fq 125.

Burimi: http://www.undp.org/content/dam/kosovo/docs/Mozaik/Kosovo_Mosaic_2012_Alb_216825.pdf

¹⁰ Gazeta "Koha Ditore". 08.02.2012. Burimi: <http://kohaditore.com/?page=1,31,134168>

¹¹ Gazeta "Koha Ditore"- 11.04.2013. Aplikuesit në Prishtinë refuzojnë pagesën për legalizim. Burimi: <http://www.koha.net/?page=1,31,142161>

¹² Portali "Indeksonline". 13 tetor 2013. Ilegalitet ndërtojnë lirshëm. Burimi: <http://www.indeksonline.net/?FaqeID=2&LajmID=32530>

dhjetor të vitit 2011 ka evidentuar në katër zona të Prishtinës (Hajvali, Zllatar, zonat e “Kodrës së Trimave” relacioni Prishtinë – Podujevë, si dhe në zonën “Qendra I”) mbi 400 ndërtime të kryera në pronën publike apo në një pjesë të pronës publike.

5. Mungesa e vend-parkingjeve për vetura. Mungesa e vend-parkingjeve, vlerësohet të jetë njëri ndër problemet madhore për qytetarët. Tollovia nga ndalja e veturave në vende jo të destinuara për ndalje dhe parkim vërehet në gjitha lagjet e Prishtinës. Këmbësoret janë të detyruar të ecin rrugës së paraparë për automjete, gjersa automjetet parkohen në vendkalime të këmbësorëve. Planet e Komunës së Prishtinës për t’i ndërtuar tri parkingje nëntokësore kanë dështuar tri herë radhazi.¹³ Në kryeqytet, ka filluar të bëhet e leverdishme hapja e parkingjeve private të cilat nuk i nënshtrohen asnjë lloj tatimi ndaj komunës apo sigurie për veturat që parkohen. Në disa raste (rruga Lidhja e Prizrenit afër tregut të gjelbër), qytetarët e kanë shfrytëzuar hapësirën publike për të hapur parking privat.

6. Mungesa e çerdheve nëpër lagjet e qytetit. Prishtina aktualisht ka tetë çerdhe publike, të koncentruara kryesisht në qendër të qytetit. Interesimi i qytetarëve për t’i dërguar fëmijët në çerdhet publike mbetet i madh. Përveç banorëve të Prishtinës, edhe banorët e komunave Obiliq dhe Fushë Kosovë kanë shprehur interesim që të sjellin fëmijët e tyre në çerdhe në Prishtinë.¹⁴ Asnjë çerdhe publike nuk është ndërtuar në Prishtinë në gjashtë vitet e fundit. Mungesa e çerdheve publike ka favorizuar hapjen e çerdheve private të cilat funksionojnë pa kritere profesionale për pranimin dhe trajtimin e fëmijëve.¹⁵ Disa sosh gjenden në katet e larta të banesave e disa të tjera në shtëpi private të ndërtuara për banim familjar. Ushqimi si dhe akomodimi janë segmentet që nuk kontrollohen dhe vlerësohen nga ana e autoriteteve gjegjëse. Prindërit e kryeqytetit të cilët i dërgojnë fëmijët në çerdhet publike kanë shfaqur edhe pakënaqësi me kohëzgjatjen e pushimit në çerdhet publike i cili rëndom fillon me 15 korrik dhe zgjatë deri me 15 gusht. Kjo praktikë është propozuar që të ndryshojë, përkatësisht që të anulohet pushimi i përnjëhershëm i stafit dhe pushimet vjetore të rregullohen në formën e tillë që të mos të mbyllet komplet për një muaj çerdhja.

¹³ Gazeta “Koha Ditore”. 26.03.2012. Prishtina edhe dy vite larg parkingjeve nëntokësore. Burimi: <http://www.koha.net/?page=1,31,93067>

¹⁴ Gazeta JNK. 18.02.2013. Çerdhet e paarritshme publike. Burimi: <http://gazetajnk.com/?cid=1,979,4726>

¹⁵ Gazeta “Koha Ditore”. 18.03.2013. Prishtina më 2 çerdhe legale dhe 38 ilegale. Burimi: <http://www.koha.net/?page=1,31,139135>

- 7. Mungesa e gjelbërimit dhe parqeve dhe ndotja e ambientit.** Banorët e Prishtinës kanë shfaqur pakënaqësi me mungesën e vendeve të gjelbëruara dhe parqeve në shumicën e lagjeve të Prishtinës. Përveç lagjes “Dardania”, lagjes së “Muhaxhirëve”, lagjes “Arbëria”, lagjes “Sofalia” dhe pjesërisht lagjes “Bregu i Diellit”, të gjitha lagjet dhe zonat e tjera të Prishtinës kanë mungesë të vendeve të gjelbëruara dhe parqeve. Mungesa e këtyre hapësirave vlerësohet të ndikojë negativisht edhe në pamjen e qytetit. Në të gjitha zonat që nuk kanë parqe dhe hapësira të gjelbëruara janë evidentuar hapësira publike të patrajtuara të cilat lehtësisht do të mund të shndërroheshin në vende të përshtatshme për parqe. Në bazë të hulumtimit të UNDP-së, ndotja e mjedisit është mjaft problem i madh dhe shqetësues në komunën e Prishtinës. Më shumë se gjysma apo 58% e banorëve të saj konsiderojnë qytetin e tyre të fëlliqur ose shumë të fëlliqur, kurse 44% e konsiderojnë të tillë lagjen e tyre. Përveç kësaj, cilësia e ajrit në afërsi konsiderohet si problem nga 31% e banorëve të Prishtinës, kurse zhurma nga 19% e tyre. Një përqindje shumë e vogël apo vetëm 36% e banorëve të Prishtinës janë të kënaqur me nivelin e pastërtisë së përgjithshme të komunës së tyre, në krahasim me 58% të kosovarëve në përgjithësi në komunat e tjera. Një përqindje akoma më e vogël (30% në krahasim me mesataren e kosovarëve 48%) janë të kënaqur me mbrojtjen e mjedisit.¹⁶
- 8. Mungesa e fushave sportive dhe rekreative.** Në shumicën e rrugëve të Prishtinës, veçmas në periferi, fëmijët hasen duke luajtur në rrugët që përkohën nga automjetet. Kjo nga qytetarët është arsyetuar me mungesë të qendrave të vogla sportive të cilat do të mundësonin që fëmijët të ushtronin aktivitete sportive brenda tyre. Një fenomen negativ i hasur në këtë drejtim është që në shumicën e oborreve të shkollave janë ndërtuar palestra të hapura sportive të cilat nuk lejohen nga drejtoria e shkollës që të shfrytëzohen gjatë ditëve të vikendit nga ana e fëmijëve të lagjeve përkatëse.
- 9. Mungesa e ndriçimit publik.** Qytetarët e lagjeve të kryeqytetit, njëherën ndër problemet me kryesore e kanë potencuar edhe mungesën e ndriçimit publik. Përveç rrugëve të lagjeve që nuk janë nën sistemin e ndriçimit

¹⁶ Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim –UNDP. “Mozaiku i Kosovës”. 2012. Fq 125.

Burimi: http://www.undp.org/content/dam/kosovo/docs/Mozaik/Kosovo_Mosaic_2012_Alb_216825.pdf

publik, janë hasur edhe zona në qendër të Prishtinës të cilat nuk kanë ndriçim gjatë natës. Zonat e lagjes “Dardania”, “Bregu i Diellit”, “Aktash”, “Velania” nuk kanë ndriçim publik në 90% të rrugëve. Mungesa e ndriçimit besohet të ndikojë edhe në aspektin e sigurisë, ngase lagjet të cilat nuk janë nën sistemin e ndriçimit publik janë më të prekura nga rastet e vjedhjeve të ndryshme. Janë evidentuar edhe lagje si lagja “Murat Xhaka” në rajonin e Kolovicës të cilët disa herë ju kanë drejtuar autoriteteve lokale të Prishtinës me qëllim që kjo e fundit të instalojë ndriçimin publik në lagjen e tyre, por edhe përkundër këtyre kërkesave, ndriçimi nuk është instaluar. Përveç problemeve të evidentuara nga mungesa e ndriçimit publik, problem paraqet edhe mos sanimi i prishjeve në zonat të cilat kanë ndriçim publik. Banorët përgjatë shumë rrugëve kanë cekur raste kur me vite të tëra nuk janë rregulluar prishjet dhe kjo rezulton edhe me rritjen e zonave që nuk kanë realisht ndriçim publik edhe përkundër që zyrtarisht numërohen si zona nën sistemin e ndriçimit publik.

10. **Mungesa e një qendre për grumbullimin e pemëve dhe perimeve në zonat malore.** Rajoni i Gollakut numëron gjithsej 16 fshatra malore të Prishtinës. Banorët e këtij rajoni merren kryesisht me bujqësi dhe blegtori. Mungesa e një qendre ku do të mund t'i shitnin produktet e tyre, dekurajon banorët e këtyre zonave. Banorët detyrohen që vetë t'i sjellin dhe shesin produktet e tyre në tregjet dhe hapësirat e Prishtinës. Shpeshherë prodhimi i tyre konfiskohen nga ana e inspektorëve komunal, ngase këta shitës shesin në rrugë dhe jo në vendet e destinuara për shitje.
11. **Mungesa e investimeve në lagjen “Dardania”.** Hapësira përball ndërtesave të gjelbërta është e shkatërruar, mungon ndriçimi publik si dhe krijohen puse me ujë të ndotur. Brenda ndërtesave të banimit vërehet mungesa e ndriçimit, mungesa e anësoreve të sigurisë në shkallë, dritaret e shkallëve janë kryesisht të thyera, mungesa e aparateve për fikjen e zjarrit si dhe në disa raste hasen të shpërfaqura kabllot e instalimit të brendshëm të energjisë. Autoritetet komunale nuk e kanë ndaluar trendin e ndryshimit të strukturës së ndërtesave, përkatësisht në këtë zonë hasen dhjetëra raste kur tarracat janë shndërruar në dhoma banimi.
12. **Mungesa e nënkalimeve në qytet.** Përveç në lagjen “Pejton” dhe afër shkollës së mesme “Ali Sokoli” ku janë ndërtuar nënkalime, përkatësisht mbikalime, në disa zona

të tjera brenda qytetit vlerësohet e rëndësishme ndërtimi i tyre. Këto zona janë, rruga “Agim Ramadani” përkatësisht afër Fakultetit Juridik ku ritmi i kalimit të udhëtareve andej e këndeje rrugës është i madh. Në rrugën “Garibaldi”, përkatësisht afër hotel “Grand”. Në rrugën “Eqrem Qabej”, afër Fakultetit Filologjik. Në rrugën “Xhorxh Bush” afër Radio Kosovës, në rrugën e “UÇK-së” afër Komunës së Prishtinës. Në rrugën “Ilir Konushevci” afër trekëndëshit si dhe në rrugën “Tirana” afër hekurudhës. Ne te gjitha këto zona kërkohet ndërtimi i nënkalimeve apo mbikalimeve përkatëse.

13. Mos publikimi i raporteve të shpenzimeve financiare.

Komuna e Prishtinës është ndër komunat e pakta që nuk ka publikuar në faqen e saj zyrtare asnjë raport financiar për shpenzimet e parasë publike. Sipas Ligjit për Financat e pushtetit lokal, nenin 45 pika 4, kryetarët e komunave për çdo tre muaj duhet të publikojnë në internet raportet përkatëse financiare që lidhen me shpenzimet e parasë publike.¹⁷ Komuna e Prishtinës nuk ka pranuar t'i bëjë publike këto raporte as pas kërkesave për qasje në dokumentet publike, proces ky i garantuar me Ligj.¹⁸

Gjërat pozitive të cilat duhet ruajtur

- 1. Parku i qytetit dhe parku i Gërmisë.** Bashkëbiseduesit në përgjithësi kanë sugjeruar që duhet ruajtur parku i qytetit në lagjen e “Muhaxhirëve” si dhe parku i Gërmisë dhe duhet investuar veçmas në zgjerimin e ndriçimit publik, ulëseve për qytetarët si dhe shportave për hedhjen e mbeturinave të imta.
- 2. Pallati i Rinisë dhe Sporteve.** Ky pallat sipas bashkëbisedueseve paraqet imazhin e dikurshëm dhe të sotshëm të Prishtinës dhe sipas tyre pamja e saj duhet të mirëmbahet, por jo të ndryshohet.
- 3. Shtëpia e Herticëve.** Ky objekt gjendet në lagjen “Kodra e Trimave” të Prishtinës dhe është i djegur gjatë kohës së

¹⁷Kuvendi i Kosovës. Ligji për menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë. Burimi: <http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2010-221-alb.pdf>

¹⁸ Instituti GAP ka kërkuar dy herë radhazi qasje në raportet financiare të Komunës së Prishtinës përmes të drejtës për qasje në dokumentet publike. Përgjigjja nga ana e zyrtarëve të kësaj komune ka qenë që këto raporte mund t'i gjeni në Ministrinë e Financave, në Departamentin e thesarit.

luftës. Gjendja aktuale e kësaj shtëpie-shkollë pasqyron periudhën e para luftës kur objektet e shtëpive private janë lëshuar për hapësira shkollimi. Nga bashkëbiseduesit është kërkuar që ky objekt të vihet nën mbrojtje institucionale.

- 4. Shtëpia e vjetër “Hivzi Sylejmani”:** Objekti më i vjetër që aktualisht është nën pronësinë e Komunës së Prishtinës është objekti i cili aktualisht shfrytëzohet si bibliotekë “Hivzi Sylejmani”. Kjo bibliotekë deri në fund të këtij viti pritet të zhvendoset në objektin e ri në lagjen “Dardania”. Objekti sipas bashkëbisedueseve duhet të konservohet.


Trendet Buxhetore në Komunën e Prishtinës

Komuna e Prishtinës është komuna me buxhetin më të madh nga gjitha komunat në Kosovë, njëkohësisht edhe njëra ndër komunat e rralla që do të ketë më shumë “shpenzime kapitale” se “paga dhe mëditje” në vitin 2013. Krahasuar me vitin 2010, komuna ka rritur buxhetin për 15.4 milionë euro. Në tri vitet e fundit, komuna ka pasur një ngritje të vazhdueshme të të hyrave vetanake, ndërsa në vitin 2012 Prishtina ka pasur gjithsej 23.2 milion euro të hyra vetanake. Struktura e të hyrave përbëhet nga taksa për leje të ndërtimit dhe legalizim (58%), tatimi në pronë (16%), taksat administrative (10%) etj. Komuna aktualisht ka të regjistruara rreth 78 mijë prona ndërsa numri i saktë i tatimpaguesve nuk është dhënë nga zyrtarët e Komunës së Prishtinës.¹⁹ Raporti i Auditorit konsideron se disa nga sfidat e komunës janë mbledhja e borxheve të tatimit në pronë nga vitet paraprake, lejet e bizneseve dhe të hyrat nga qiraja dhe shfrytëzimi i pronave komunale.²⁰ Në vazhdim, raporti thekson se në vitin 2012 komuna ka realizuar 74% të buxhetit mirëpo buxhetin për shpenzime kapitale e ka realizuar vetëm 56%. Së fundmi, Raporti i Auditorit ka gjetur se në një numër kontratash ka pasur vonesa të konsiderueshme p.sh. rindërtimi i rrugëve dhe kanalizimeve në “MAT-Grupi 2”, ndërsa për 8 kontrata nuk është vazhduar sigurimi i ekzekutimit të kontratës.

¹⁹ Komuna e Prishtinës, Përgjigje në Kërkesën e Instituti GAP, 19 Gusht 2013

²⁰ ZAP, Raporti I Auditimi mbi Pasqyrat Financiare të Komunës së Prishtinës Mbyllur me 31 Dhjetor 2012, 06 Gusht 2013, http://oag-rks.org/repository/docs/RaportiAuditimit_KPR_2012_Shqip_338390.pdf


Figura 1. Buxheti i Komunës së Prishtinës 2013



Burimi: <http://www.institutigap.org/spendings/?prishtine/2013#/~/prishtine>

Në bazë të grafikonit të mëposhtëm shohim se Komuna e Prishtinës vazhdimisht ka pasur një dominim të shpenzimeve kapitale mirëpo shqetësuese është rënia që kanë shënuar këto shpenzime në vitin 2012.

Figura 2. Trendet Buxhetore 2011- 2013



Në bazë të Kornizës Afatmesme të Buxhetit 2014-2016, Komuna e Prishtinës planifikon një rritje të lehtë të shpenzimeve në tri vitet e ardhshme. Është me interes të ceket se duke krahasuar vitin 2016 me 2014, komuna planifikon një rritje të shpenzimeve në mallra dhe shërbime prej 3.3 milion euro. Në anën tjetër, në vitin 2016 investimet kapitale vlerësohet se do të ulen për 1.6 milion euro.

Tabela 1. Planifikimi i shpenzimeve 2014-2016

Kategoria	2014	2015	2016
Paga dhe Mëditje	22.250.000	22.250.000	22.250.000
Mallra dhe Shërbime	5.510.011	6.601.325	8.850.458
Subvencione dhe Transfere	1.540.258	1,000,000	1.000.000
Investime Kapitale	32.187.500	32.500.150	30.897.122
Shpenzime komunale	1.800.000	1.800.000	1.800.000
Totali	63.287.769	64.151.475	64.797.580

Metodologjia e hartimit të raportit

Instituti GAP në bashkëpunim me Rrjetin Ballkanik për Gazetari Hulomtuese (BIRN) janë aktiv në fushën e qeverisjes lokale dhe fushatave para zgjedhore që nga zgjedhjet lokale të 2007. Përgjatë këtyre viteve, në bazë të punës hulomtuese dhe analitike, janë grumbulluar informata të respektueshme për nivelin e qeverisjes lokale, problemet kryesore dhe trendët buxhetore të komunave.

Identifikimi i problemeve kryesore në Komunën e Prishtinës është bërë përmes intervistave dhe fokus grupeve me njerëzit aktiv të komunës, si gazetarë, pjesëtarë të shoqërisë civile, etj. Të gjeturat e GAP dhe BIRN janë krahasuar edhe me të dhënat e hulomtimit më të mëdha që janë bërë viteve të fundit në nivel lokal, ai i UNDP (Mozaiku i Kosovës 2012-shërbimet publike dhe qeverisja lokale në fokus) dhe DEMI/USAID (Raport i Anketimit mbi Kënaqshmërinë e Qytetarëve me Shërbimet Komunale, 2012), etj.



Instituti për Studime të Avancuara GAP është një Think-Tank i themeluar në tetor të 2007 në Kosovë. Qëllimi kryesor i GAP-it është të tërheq profesionistë për të krijuar një ambient të zhvillimit dhe hulumtimit profesional, që haset në institucione të ngjashme në shtetet perëndimore. Kjo gjithashtu u ofron mundësi kosovarëve për hulumtimin, zhvillimin dhe implementim e projekteve me qëllim të avancimit të shoqërisë kosovare. Prioritet për këtë Institut është mobilizimi i profesionistëve në adresimin e sfidave ekonomike, politike dhe sociale të vendit. Qëllimet kryesore të GAP-it janë të mbush zbrazëtitë në mes të qeverisë dhe qytetarëve, si dhe të mbushë zbrazëtitë në mes të problemeve dhe zgjidhjeve.